



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHOQATA KOMBËTARE E AUTOSHKOLLAVE

Tiranë me 01.03.2023

DEKLARATË PËR MEDIAT

Ditët e fundit opinionioni publik, mediat dhe kushdo tjetër kanë reaguar ashpër kundër vendimit për rritjen e cmimit të pajisjes së qytetarëve me leje drejtimi (patentë).

Duam tju sigurojmë se në asnjë rrethanë qëllimi ynë si Shoqatë Kombëtare e Autoshkollave nuk ka qenë e asnjë do të jetë që të rëndojmë mbi xhepat e shqiptarëve por kërkojmë formalizimin e këtij biznesi.

Në këto kushte vlen të theksohet se :

Vendimi për pezullimin e Akt-Marrëveshjes historike mes DPT, Autoshkollave dhe DPSHTRR, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës as nuk e mbyll e as nuk e shmang problemin që synon të zgjidhë ky bashkëpunim, për të luftuar konkurrencën e pandershme dhe evazionin e lartë në fushën e Autoshkollimit.

Qartësojmë se ky treg ka nevojë urgjente që programet e përgatitjes së kandidatëve për drejtues mjete cka përkthehet në një vleresim të kostove referuese për të garantuar ligjërisht disa objektiva të rëndësishëm:

1. Realizimi i plotë e cilësor i Programit të detyrueshëm zyrtar të përgatitjes së kandidatëve për drejtues mjete.
2. Pagesa e taksave dhe tatimeve në mënyrë të barabartë duke u bazuar në kostot referuese të domosdoshme për realizimin e Programit.
3. Formalizimi i tregut përmes fiskalizimit dhe transaksioneve bankare.
4. Transparenca e mbikëqyrjes dhe kontrolleve teknike dhe fiskale.
5. Rikthimi i dinjitetit, profesionalizmit dhe rimëkëmbje e sektorit të Autoshkollave.

Në këto kushte për të shmangur informalitetin duhet të jetë e përcaktuar që cmimet e kostos dhe pagesat të kryhen përmes mandatit bankar të deklaruar. Kjo shmang konfuzionin që krijon mungesa e tarifave minimale për programet mësimore, pra **FORMALIZIM TË TREGUT** .

Për pasoje vendosja e vlerave financiare dhe kostove referuese të programeve mësimore kërkon në mënyrë të drejtpërdrejtë rritjen e rolit të shtetit dhe enteve përkatëse si rregullatore dhe arbiter në tregun e këtij biznesi, duke bërë të mundur përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e cilësisë së drejtuesve të mjeteve.

Programi përgatitjes së kandidatëve për drjetues mjeti ka kosto financiare dhe nuk mund të vazhdojë të mbetet në dorë të abuzuesve, mashtruesve dhe seksereve të cilët vijojnë të shantazhojnë këtë biznes përmes gjobave informale .

FORMALIZIM FORMALIZIM FORMALIZIM duhet të jetë kryefjala e këtij tregu. Prandaj ne si Shoqatë Kombëtare e Autoshkollave bëjmë me dije të gjithë anëtarësisë , se jemi të palëkundur për vendosjen e këtij sektori në kushte të barabarta ligjore!

Në emër të Shoqatës Kombëtare të Autoshkollave shpreh besimin se do të gjejme mbështetjen e institucioneve dhe enteve përkatëse publike për arritjen e këtyre objektivave dhe realizimin e qëllimit final që drejtuesit e mjeteve në Shqipëri të kenë edukim bashkëkohor, sipas standarteve të BE, ku ne duam të shkojmë.

Siguria rrugore në rruget tona duhet të rritet dhe kjo siguri nis nga ABC: pajisja me leje drejtimi të drejtuesve të rinj të automjeteve, të cilët përgatiten me programet mësimore më të mira të mundshme. `

Faleminderit.

Tonin Gjinaj
Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA KOMBËTARE E AUTOSHKOLLAVE